

20150511971

L I G J
PËR EKONOMI TË UJËRAVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohen ekonomizimi, përdorimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e hidrosistemeve, sistemeve të ujitjes dhe sistemeve për kullim.

Neni 2

Qëllimet e ligjit

Qëllimet e këtij ligji janë:

- sigurimi i menaxhimit ekonomik, përdorimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e hidrosistemeve, sistemeve për ujitje dhe sistemeve për kullim (në tekstin e mëtejshëm: sisteme);
- përkufizimi i vëllimit të shërbimeve që u jepen konsumatorëve të ujit nga kryerësi i veprimtarisë së ekonomisë së ujërave;
- vendosja e kushteve për punë normale dhe me sukses të kryerësit të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave dhe përdorimi i shërbimeve të tyre nga përdoruesit e ujit dhe
- themelimi i shoqërisë aksionare në pronësi shtetërore SHA Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë.

Neni 3

Definicionet

Nocionet e përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

1. "Kryerës i veprimtarisë së ekonomisë së ujërave" është shoqëria aksionare, që është themeluar, punon dhe pushon të punojë sipas dispozitave të këtij ligji, si dhe ndërmarrjet e ekonomisë së ujërave të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë që në kuadër të punës së tyre, i zbatojnë dispozitat e këtij ligji;
2. "Rajon i veprimtit" është rajon i caktuar gjeografik në kufijtë e të cilit kryerësi i veprimtarisë së ekonomisë ujore e kryen punën e vet drejtpërdrejt ose nëpërmjet njërive rajonale;
3. "Hidrosistem" është tërësia e objekteve hidroteknike me të cilat rregullohet regjimi i përdorimit të ujërave, që përfshin një ose më shumë diga me akumulime dhe/ose ujëmbledhës, kanale për prurjen dhe/ose shkarkimin e ujit, përfshirë edhe ndërtimet shpërndarëse, ndarjet, rrjedhat, kalimet, pjesët mbrojtëse, stacionet e pompave, objektet për mbrojtjen e akumulimeve nga mbushja me lym, kanalet shpuese dhe mbrojtëse dhe infrastruktura përcjellëse - rrugët, ndërtesat dhe toka nën dhe në afërsi të objekteve hidroteknike në vëllimin e nevojshëm për përdorimin dhe mirëmbajtjen e objekteve;
4. "Sistem i ujitjes" është tërësia e objekteve hidroteknike me të cilat mblidhet dhe dërgohet ujë për ujitjen e tokës bujqësore dhe tjetër, që në veçanti përfshin ujëmbledhës, stacione të pompimit dhe kanale me infrastrukturë përcjellëse - rrugët, ndërtesat dhe tokën nën dhe në afërsi të objekteve hidroteknike në vëllimin e nevojshëm për përdorimin dhe mirëmbajtjen e objekteve;
5. "Sistem për kullim" është tërësia e objekteve hidroteknike me të cilat bëhet mbrojtja dhe kullimi i tokës bujqësore dhe tjetër, rrugëve dhe zonave të urbanizuara, që në veçanti përfshin, digat mbrojtëse, kanalet dhe stacionet e pompimit me infrastrukturë përcjellëse - rrugët, ndërtesat dhe tokën nën dhe në afërsi të objekteve hidroteknike në vëllimin e nevojshëm për përdorimin dhe mirëmbajtjen e objekteve;

6. "Ndërmarrje komunale për furnizim me ujë" është person juridik publik sipas Ligjit për vetadministrim lokal ose çdo person ose ndërmarrje tjetër që ka të drejtë ligjore për të punuar me sistem të furnizimit me ujë të një qyteti, fshati ose vendbanimi për distribuimin e ujit për konsumim nga njeriu (ujë të pijshëm dhe nevoja tjera) dhe nevojat teknologjike;

7. "Pikë e furnizimit me ujë", domethënë vendi i kanalit kryesor, objektit ose gypit prej ku sigurohet dhe dërgohet një sasi e caktuar e ujit ose rrjedhës, nga i cili përdoruesi i ujit mund të thithë ose të nxjerrë ujë për nevojat personale;

8. "Shfrytëzues i ujit" është personi fizik që shfrytëzon shërbimet e dërgesave të ujit nga ekonomia e ujërave për: ujitje, konsumim nga personi (pirje dhe nevoja tjera), nevoja industriale teknologjike (ekonomike) përfshirë edhe prodhimtarinë e energjisë elektrike (në tekstin e mëtejshëm: përdoruesi) dhe

9. "Ujërat e derdhura" janë të gjitha ujërat e zeza dhe ujërat atmosferike që derdhen nga objektet ekonomike dhe industriale, sistemet e kanalizimit, oranzheritë, rrugët, aeroportet dhe objekte tjera private dhe publike në sistemin e kullimit.

Neni 4

Interesi publik

(1) Veprimtaritë e ekonomisë së ujërave janë veprimtari me interes publik.

(2) Për kryerje të veprimtarive të ekonomisë së ujërave Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka themeluar shoqërinë aksionare Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: SHA Ekonomia e Ujërave).

(3) Shoqëria aksionare nga paragrafi (2) i këtij neni bazohet dhe punon në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare.

(4) Krahas veprimtarive me interes publik, SHA Ekonomia e Ujërave kryen edhe veprimtari tjera që janë të përcaktuara në Statutin e SHA Ekonomia e Ujërave.

(5) Përveç SHA Ekonomia e Ujërave, veprimtari të ekonomisë së ujërave kryejnë edhe ndërmarrjet publike Hidrosistemi Zletovica, Strezheva dhe hidrosistemi Lisiçe të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë që në kuadër të punës së tyre, për veprimtaritë e ekonomisë së ujërave i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

II. KOMPETENCA

Neni 5

Lënda e punës

SHA Ekonomia e Ujërave i shfrytëzon, mirëmban dhe menaxhon me sistemet e ujitjes dhe kullimit në tërësi, për shkak të:

- furnizimit me ujë për ujitje;
- furnizimit me ujë të ndërmarrjes komunale për furnizim me ujë për konsumim nga njeriu (ujë i pijshëm dhe nevoja tjera);
- furnizimit me ujë për nevojat industriale dhe teknologjike (ekonomike) përfshirë edhe prodhimin e energjisë elektrike;
- rregullimit të shtretërve të lumenjve;
- kullimit të tokës dhe
- kthimit të ujërave të rrjedhshme.

Neni 6

Obligimi për ujitje dhe kullim

(1) SHA Ekonomia e Ujërave bën furnizime me ujë për ujitje të subjekteve juridike dhe fizike, pronarë dhe/ose shfrytëzues të tokës bujqësore në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) SHA Ekonomia e Ujërave bën edhe kullimin për personat juridikë dhe fizikë, pronarë ose përdorues të tokës bujqësore ose tokës tjetër, rrugëve dhe zonave të urbanizuara, nëse në kuadër të rajonit të veprimit ekziston edhe sistemi i kullimit.

(3) SHA Ekonomia e Ujërave kullimin e bën në të gjitha sipërfaqet dhe objektet që i takojnë sistemit të ujitjes.

(4) SHA Ekonomia e Ujërave mund të kryejë kullim edhe jashtë sistemit për kullim në rajonin e veprimit në bazë të marrëveshjes së lidhur.

(5) SHA Ekonomia e Ujërave kryen edhe shkarkimin e ujërave të derdhura në sistemet për kullim në rajonin e veprimit, në pajtim me dispozitat për lëshimin e ujërave të këtilla nga Ligji për ujëra.

Neni 7

Bashkëpunimi me ndërmarrjet komunale

SHA Ekonomia e Ujërave, në kuadër të rajonit të veprimit mund të kryejë furnizime më ujë për ndërmarrjet komunale të furnizimit me ujë, për persona juridikë për nevoja industriale dhe teknologjike (ekonomike), përfshirë edhe prodhimin e energjisë elektrike, vetëm kur atë e mundëson sistemi në pajtim me dokumentacionin projektues sipas së cilit është ndërtuar me kushte dhe mënyrë në pajtim me këtë ligj.

Neni 8

Prodhimi i energjisë elektrike

SHA Ekonomia e Ujërave mund të prodhojë dhe shesë energji elektrike vetëm në rastet kur hidrocentrali paraqet një pjesë të sistemit me të cilin menaxhon ekonomia e ujërave, ndërsa në pajtim me lejen për shfrytëzimin e ujit.

Neni 9

Mënyra e realizimit të kompetencave

(1) Për realizimin e kompetencave të veta, SHA Ekonomia e Ujërave në kuadër të rajonit të veprimit kryen:

- ndërtimin, mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e objekteve hidroteknike;

(2) Gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj, SHA Ekonomia e Ujërave:

- siguron shërbime optimale për shfrytëzuesit e ujit;

- siguron trajtim të barabartë gjatë dhënies së shërbimeve për të gjithë shfrytëzuesit e ujit;

- llogarit dhe i arkëton kompensimet për shërbimet që i siguron;

- ndërmerr masa për përdorim racional të ujit, për uljen e humbjeve të ujit në minimum;

-ndërmerr masa për kursimin e ujit;

- menaxhon me përgjegjësi me mjetet e veta, duke punuar me to në mënyrë të kujdesshme dhe në mënyrë efikase;

- e mirëmban dhe siguron përdorimin efikas dhe të qëndrueshëm të përdorimit të sistemit me të cilin menaxhon dhe

- i zbaton rregullat nga sfera e kompetencës së saj, si dhe për aktet e përgjithshme dhe të veçanta që i miraton.

(3) SHA Ekonomia e Ujërave është e obliguar që të plotësojë kushtet dhe kërkesat ligjore, e para se gjithash, të marrë të gjitha lejet e nevojshme, dhe autorizimet tjera në lidhje me përdorimin e resurseve ujore dhe mbrojtjes së ambientit jetësor dhe natyrës, që kanë të bëjnë me menaxhimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.

Neni 10 **Masat e sigurisë**

Me qëllim që të sigurojë punë efikase e sistemit, të mbrojë ose garantojë siguri të objekteve që i takojnë sistemit, dhe kryejnë mbrojtje dhe siguri nga vërshimet në pajtim me Ligjin për ujëra, SHA Ekonomia e Ujërave me mjetet nga programi i organit kompetent për menaxhimin e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor:

- ndërton dhe mirëmban objektet për mbrojtjen nga vërshimet;
- ndërton dhe mirëmban objektet për parandalimin dhe mbrojtjen nga erozioni;
- ndërton dhe mirëmban objektet për rregullimin e lumenjve, rrjedhave dhe
- kryen punë tjera në pajtim me ligjin.

Neni 11 **Zbatimi i Ligjit për furnizime publike**

SHA Ekonomia e Ujërave, furnizimet e mallrave, shërbimet dhe punët e nevojshme për punën e vet i kryen në pajtim me rregullat për furnizime publike.

Neni 12 **Servituti i përkohshëm**

(1) Për shkak të realizimit të punëve nga nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, SHA Ekonomia e Ujërave mund të miratojë aktvendim me të cilin vendos servitut të përkohshëm mbi parcelat e përfshira me punët, në pajtim me ligjin.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, pala mund të parashtojë ankesë, në afat prej 8 (tetë) ditësh, te Këshilli i Drejtorëve të SHA Ekonomia e Ujërave.

(3) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Neni 13 **Përrjashtimi në raste urgjente**

Në rastet kur ekziston urgjencë ose nevojë për pengimin e rrezikut nga shkaktimi i dëmit në sistem dhe/ose parcelat që i furnizon me ujë ose i kullon, SHA Ekonomia e Ujërave ka të drejtë për qasje dhe përdorim të tokës në pronësi private ose në bazë të së cilës ekziston një e drejtë e përdorimit pa vendosjen e servitutit nga neni 12 i këtij ligji, me ç'rast në afat prej 24 orëve është e obliguar t'i njoftojë ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi të Ujërave.

Neni 14 **Kompensimi i dëmit**

(1) Gjatë vendosjes së servitutit të përkohshëm nga neni 12 i këtij ligji dhe rastet nga neni 15 i këtij ligji, SHA Ekonomia e Ujërave përgjigjet për dëmin që pronari ose shfrytëzuesi i tokës e ka pësuar, sipas dispozitave të Ligjit për marrëdhënie obliguese.

(2) Pas punëve të kryera SHA Ekonomia e Ujërave është e obliguar që tokën dhe objektet t'i kthejë në gjendjen fillestare.

Neni 15

Mundësia për eksproprijim

Për shkak të realizimit të veprimtarive, SHA Ekonomia e Ujërave mund të ngrejë procedurë për eksproprijim të tokës në pajtim me rregullat për eksproprijim.

III. DISPOZITAT STATUSORE

Neni 16

Rajoni i veprimit

(1) SHA Ekonomia e Ujërave themelohet me qëllim të kryerjes së veprimtarive të ekonomisë së ujërave në rajonin e tërë territorit të Republikës së Maqedonisë.

(2) SHA Ekonomia e Ujërave ka drejtori dhe njësi rajonale për kryerjen e veprimtarive të ekonomisë së ujërave në rajon të caktuar gjeografik të veprimit.

(3) Çdo njësi rajonale e SHA Ekonomia e Ujërave ka seli të regjistruar që gjendet në rajonin e veprimit.

(4) Me statutin e SHA Ekonomia e Ujërave përcaktohet numri dhe rajoni i veprimit të njërive rajonale.

Neni 17

Aktet e SHA Ekonomia e Ujërave

(1) SHA Ekonomia e Ujërave në pajtim me Statutin miraton aktet për mënyrën e punës dhe shfrytëzimin e sistemit me të cilin menaxhon që i përfshijnë procedurat për:

- shfrytëzimin e ujit që dërgohet;
- parashtrimin e kërkesës për dërgimin e ujit dhe veprimit me të;
- njoftimin e shfrytëzuesve për vendimet që i miratojnë organet udhëheqëse dhe
- në rast të thatësisë dhe situatave të ngjashme që e pamundësojnë punën e rregullt.

(2) Për aktet nga paragrafi 1 i këtij neni jep pëlqim Qeveria e Republikës së Maqedonisë

IV. MËNYRA E MENAXHIMIT

Neni 18

Organet e menaxhimit

(1) Organ i menaxhimit të SHA Ekonomia e Ujërave është:

- Këshilli i Drejtorëve.

(2) Zgjedhja, mandati, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit të Drejtorëve kryhen në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe Statutin e SHA Ekonomia e Ujërave.

V. MARRËDHËNIET ME SHFRYTËZUESIT

Neni 19

Marrëveshjet dhe aktvendimet

(1) SHA Ekonomia e Ujërave shërbimet e saj të ujitjes dhe kullimit, për dorëzimin e ujit të papërpunuar për furnizim, për nevoja industriale dhe teknologjike, për prodhimin e energjisë elektrike si dhe për shkarkimin e ujërave të derdhura i realizon në bazë të marrëveshjes dhe/ose aktvendimit me përdoruesit përkatës.

(2) Marrëveshjet lidhen për çdo vit ose si marrëveshje shumëvjeçare me afat të vlefshmërisë jo më të gjatë se 10 (dhjetë) vite.

Neni 20

Marrëveshja për furnizim me ujë për ujitje

(1) SHA Ekonomia e Ujërave bën furnizime me ujë për ujitje në bazë të marrëveshjes së lidhur.

(2) Bartës i marrëveshjes mund të jetë personi juridik ose fizik që ka sipërfaqe personale bujqësore ose sipërfaqe me koncesion ose me qira. Statusi i sipërfaqes dëshmohet me dokument adekuat për pronësi, koncesion ose qira.

(3) Bartësi i marrëveshjes mund të jetë person fizik i cili ka sipërfaqe bujqësore të cilën e shfrytëzon edhe në baza të tjera.

Neni 21

Aktivendimi për kullim

(1) SHA Ekonomia e Ujërave bën kullimin në tokat bujqësore ose tokat tjera, objektet dhe objekte infrastrukturore vetëm nëse ato janë në kuadër të sistemit për kullim.

(2) Për punët e tilla, SHA Ekonomia e Ujërave te përdoruesit lëshon aktivendim.

(3) SHA Ekonomia e Ujërave lëshon aktivendim për kullim për personin juridik ose fizik që ka sipërfaqe personale bujqësore ose sipërfaqe me koncesion ose me qira. Statusi i sipërfaqes dëshmohet me dokument adekuat për pronësi, koncesion ose qira.

(4) SHA Ekonomia e Ujërave lëshon aktivendim për objektet (oranzheritë, serrat, sallat dhe objektet tjera ekonomike dhe industriale, objektet shtetërore dhe ato individuale, sipërfaqet e oborreve dhe parqeve, rrugëve, aeroporteve etj.) për pronarët ose përdoruesit e atyre objekteve.

Neni 22

Marrëveshja për shkarkimin e ujërave të derdhura

(1) SHA Ekonomia e Ujërave bën shkarkimin e ujërave të derdhura nga objektet dhe objektet infrastrukturore vetëm nëse ato janë në kuadër të sistemit për kullim.

(2) Punët e shkarkimit të ujërave të derdhura, SHA Ekonomia e Ujërave me përdoruesit i rregullon me marrëveshje.

(3) SHA Ekonomia e Ujërave lidh marrëveshje për shkarkimin e ujërave të derdhura me personat juridikë, fizikë, organet e administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit.

(4) SHA Ekonomia e Ujërave lidh marrëveshje për shkarkimin e ujërave të derdhura edhe me pronarët ose shfrytëzuesit e këtyre objekteve (oranzheritë, serrat, sallat dhe objektet tjera ekonomike dhe industriale, objektet shtetërore dhe ato individuale, sipërfaqet e oborreve dhe parqeve, rrugëve, aeroporteve e ngjashëm).

(5) Bartës të marrëveshjeve për shkarkimin e ujërave të derdhura mund të jenë edhe persona komunalë dhe persona tjerë që e lëshojnë ujin në sistemet e kullimit me të cilat menaxhon SHA Ekonomia e Ujërave.

(6) Për lidhjen e marrëveshjes për shkarkimin e ujërave të derdhura, përdoruesit duhet të posedojnë leje për lëshim të ujërave në pajtim me Ligjin për ujëra.

Neni 23

Marrëveshje për furnizim me ujë për ndërmarrjet komunale dhe përdoruesit e tjerë

(1) SHA Ekonomia e Ujërave dorëzon ujë për ndërmarrjet komunale për furnizim me ujë dhe përdoruesit e ujit për nevoja industriale dhe nevoja tjera, përfshirë edhe dërgesat e ujit për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm në bazë të marrëveshjeve vjetore dhe/ose marrëveshjeve afatgjata për furnizim me ujë.

(2) Kohëzgjatja e çdo marrëveshjeje afatgjatë për furnizim me ujë, përcaktohet në periudhë prej 10 (dhjetë) viteve, kurse me kërkesë të palës së interesuar kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtë, por jo më e shkurtë se 5 (pesë) vite.

Neni 24

Përmbajtja e marrëveshjeve

(1) Marrëveshjet nga neni 20 i këtij ligji në veçanti përmbajnë të dhëna për:

- vendin e dërgesës së ujit deri te sipërfaqet e shfrytëzuesit;
- mënyrën e shfrytëzimit të ujit nga shfrytëzuesi;
- periudhat e dërgesës së ujit gjatë vitit;
- lartësinë e kompensimit për shërbimin dhe afatin e pagesës;
- kushtet e domosdoshme për sigurimin e shpërndarjes së drejtë dhe të barabartë të ujit, e që dalin nga kapaciteti dhe kufizimet fizike të sistemit;
- masat që duhet të ndërmerren me qëllim të uljes së efekteve të dëmshme nga burimet difuzive të ndotjes, nga salinizimi dhe nga mbingarkimi i sipërfaqes me ujë;
- kushtet me të cilat promovohet përdorimi racional i ujit ose që janë të domosdoshme për implementimin e obligimeve ligjore të ekonomisë së ujit në drejtim të përdorimit të ujit;
- të drejtat për furnizim me ujë dhe protokollin e sigurisë së furnizimit me ujë;
- obligimet dhe kufizimet e obligimeve;
- dënimet kontraktuese të parapara për shkelje të obligimeve kontraktuese;
- të dhënat tjera që janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose ligje tjera të miratuara në pajtim me ligj;

- procedurën për parashtrimin e kërkesës për dërgimin e ujit gjatë sezonit të ujitjes;
- sasinë maksimale të ujit që mund të kërkojë përdoruesi gjatë çdo sezoni të ujitjes dhe
- të drejtën e kufizimit të dërgimit të ujit nga SHA Ekonomia e Ujërave

(2) Marrëveshjet nga neni 22 i këtij ligji përmbajnë edhe të dhëna për:

- lokacionin e vendit të lëshimit,
- të dhëna për prejardhjen e ujit që lëshohet;
- të dhëna për kualitetin e ujit që lëshohet;
- të dhëna për sasinë e ujit që lëshohet dhe
- të dhëna dhe kushte tjera të përcaktuara me lejen për lëshim.

(3) Marrëveshjet nga neni 23 i këtij ligji, përmbajnë edhe të dhëna për:

- sasinë e ujit që duhet të dërgohet te shfrytëzuesi;
- të drejtën e restriksionit në raste saktë të caktuara dhe
- planin mujor i dërgimit të ujit në rast të restriksionit.

Neni 25

Prishja e marrëveshjes

(1) SHA Ekonomia e Ujërave, ka të drejtë që të shfuqizojë marrëveshjen dhe ta ndërpresë furnizimin me ujë, në rast kur pala tjetër kontraktuese vonon me plotësimin e obligimeve të saj kontraktuese, më shumë se 60 ditë nga dita e arritjes së obligimit, pa marrë parasysh vëllimin e obligimit të paplotësuar, si dhe në raste tjera të prishjes së njëanshme të marrëveshjes në pajtim me Ligjin për marrëdhënie obliguese.

(2) Për prishjen e njëanshme të marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni, SHA Ekonomia e Ujërave e njofton me shkrim përdoruesin në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për prishjen e marrëveshjes.

Neni 26
Fuqia madhore

(1) Në rast të fuqisë madhore, nëse vjen deri te zvogëlimi e ujit të dedikuar për përdoruesit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me kërkesë të SHA Ekonomia e Ujërave ose përdoruesve shpallë gjendjen e fuqisë madhore me vendim.

(2) SHA Ekonomia e Ujërave është e obliguar që t'i njoftojë të gjithë përdoruesit në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit të vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Njoftimi nga paragrafi (2) i këtij neni kryhet nëpërmjet mjeteve lokale të informimit dhe theksohet në tabelën e shpalljeve të SHA Ekonomia e Ujërave.

(4) Pas shpalljes së fuqisë madhore, SHA Ekonomia e Ujërave fillon me zbatimin e restriksionit për furnizim me ujë, në pajtim me protokollin për siguri të furnizimit me ujë në kushte të fuqisë madhore.

VI. PUNA MATERIALE DHE FINANCIARE

Neni 27
Burimet e financimit

Burimet e mjeteve të SHA Ekonomia e Ujërave janë:

- kompensimet për shërbimet e furnizimit me ujë;
- kompensimet për kullim;
- kompensime për kthimin e ujërave të lëshuara;
- kreditë;
- të hyrat nga veprimtaritë e sferave të tjera në pajtim me statutin e shoqërisë;
- mjetet e siguruar nga Programe për ujëra dhe programe tjera të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin;
 - të hyra nga shitja e lëndëve të para minerale (rërë, zhavorr, gurë e të tjera) në pajtim me Ligjin për lëndë të para minerale;
 - donacione dhe
 - burime tjera.

Neni 28
Shpërndarja e fitimit dhe mbulimi i humbjes

Për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjes së SHA Ekonomia e Ujërave, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare.

Neni 29
Kompensimet

(1) SHA Ekonomia e Ujërave paguan:

- kompensim për ujitje,
- kompensim për kullim,
- kompensim për shkarkimin e ujërave të derdhura dhe
- kompensim për sasi të dërguar të ujit për furnizim me ujë dhe për nevoja industriale.

(2) Lartësia e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet në pajtim me metodologjinë për përcaktim të kompensimit të cilin e miraton Qeveria e RM-së në propozim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

(3) Kompensimet nga paragrafi (1), alinetë 1 dhe 2 të këtij neni i paguajnë të gjithë pronarët ose shfrytëzuesit në korniza të sistemit për ujitje përkatësisht kullim.

Neni 30

Baza për përcaktim të kompensimeve

SHA Ekonomia e Ujërave i përcakton kompensimet për shërbimet e veta me vendim për të cilin pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të:

- llogaritet shpenzimi i plotë i ujit të dërguar shfrytëzuesve;
- kompensimi për shërbime për ujitje dhe kullim të jetë i vetëm dhe i bazuar në kritere të njëjta për të gjithë sistemin, përveç për pjesë të sistemit ku ekziston dallim i rëndësishëm në shpenzimet i cili ndikon në lartësinë e kompensimit, siç është burim tjetër i ujit ose rajon i cili shfrytëzon pompë;
- në kompensimet për shërbime përfshihen shpenzimet për mirëmbajtje dhe punë të sistemit, pjesë rezerve, zëvendësim i stabilimenteve të harxhuara dhe objekte dhe mbulim i rreziqeve nga thatësia, përmbytjet ose dëmi i rastësishëm;
- gjatë shfrytëzimit të infrastrukturës së njëjtë nga më shumë shfrytëzues, pagesa e kompensimit për shërbime të jetë proporcionale me sasinë e ujit për shfrytëzues;
- amortizimi mund të jetë i përfshirë në kompensimin për shërbim nëse shpenzimi real përfshin kamatë dhe kthim të kryegjësë së kredisë, ku këto shpenzime plotësuese duhet të jenë të kthyer në pjesë të barabartë nga të gjithë shfrytëzuesit.

Neni 31

Kompensimi për ujitje

(1) SHA Ekonomia e Ujërave, paguan kompensim për ujitje nga persona juridikë ose fizikë, pronarë dhe/ose shfrytëzues të tokës bujqësore të cilët shfrytëzojnë ujë për ujitje në bazë të marrëveshjes së lidhur.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga:

- kompensimi vjetor dhe
- kompensimi për sasi të dërguar të ujit, për sipërfaqe që ujiten.

(3) Kompensimi vjetor nga paragrafi (2) alineja 1 të këtij neni është shumë e shpenzimeve për mirëmbajtjen rrjedhëse vjetore të sistemit dhe paguhet deri më 31 dhjetor për vitin rrjedhës, apo ndryshe nëse ajo është caktuar në statutin e ekonomisë së ujërave ose në aktet e saj interne dhe e paguajnë të gjithë shfrytëzuesit deri në sipërfaqet e të cilëve ka mundësi teknike që të sigurohet ujë për ujitje.

(4) Kompensimi për sasi të dërguar të ujit nga paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni, është shumë e shpenzimeve sipas volumit të sasisë së shpenzuar përkatësisht të përcaktuar të ujit të dërguar te shfrytëzuesit.

Neni 32

Kompensimi për kullim

(1) SHA Ekonomia e Ujërave, paguan kompensim për kullim nga persona juridikë ose fizikë, pronarë ose shfrytëzues të tokës bujqësore dhe tokës tjetër, njësitë të vetadministrimit lokal dhe subjekte tjera shtetërore të cilët janë pronarë ose shfrytëzojnë tokë, ose objekte, ndërsa i takojnë sistemit për kullim me të cilat ekonomizon SHA Ekonomia e Ujërave, në pajtim me nenin 21 paragrafin 4 të këtij ligji.

(2) SHA Ekonomia e Ujërave, përcakton dhe paguan kompensim për kullim nga çdo person juridik ose fizik në korniza të sistemit për kullim:

- i cili është pronar ose shfrytëzues i tokës,
- i cili ka të drejtë të shfrytëzimit ose qirasë së tokës shtetërore, dhe
- zotërues tjerë ose shfrytëzues të objekteve të infrastrukturës dhe objekteve të tjera nga të cilat uji kthehet nëpërmjet të sistemi për kullim.

(3) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni është shumë e shpenzimeve për mirëmbajtjen rrjedhëse vjetore të sistemit dhe paguhet deri më 31 dhjetor për vitin rrjedhës, ose ndryshe nëse ajo është caktuar në statutin e ekonomisë së ujërave ose në aktet e saj interne.

Neni 33

Mënyra e përcaktimit të kompensimit për kullim

(1) Lartësia e kompensimit për kullim nga neni 32 i këtij neni, përcaktohet në mënyrën në vijim:

- përcaktohet shuma vjetore e shpenzimeve për mirëmbajtje të sistemit për kullim;
- përcaktohet sipërfaqja e përgjithshme të cilën e mbulon sistemi për kullim sipërfaqja e objekteve dhe objektet e infrastrukturës nga neni 21 paragrafi 4 të këtij ligji në korniza të sistemit;
- përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes së sipërfaqes së parcelës pronë ose shfrytëzim i të drejtës ose person fizik në sipërfaqen e përgjithshme të tokës dhe
- përqindja e përcaktuar nga alineja 3 e këtij neni, shumëzohet me shumë vjetore të shpenzimeve dhe përcaktohet shuma të cilën duhet ta paguajë pronari përkatësisht shfrytëzuesi i tokës.

(2) Drejtori i SHA Ekonomia e Ujërave me aktvendim e përcakton lartësinë dhe afatin e pagesës së kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi 2 i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë ankese te Bordi i Drejtorëve në afat prej 15 ditësh.

(4) Vendimi i plotfuqishëm ka cilësi të dokumentit ekzekutiv dhe kryhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarrim.

Neni 34

Kompensimi për shkarkim të ujërave të derdhura

(1) SHA Ekonomia e Ujërave, paguan kompensim për shkarkimin e ujërave të derdhura nga shfrytëzues në bazë të marrëveshjes së lidhur në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni është shumë e shpenzimeve të shërbimit për lëshim, shpenzimet për mbrojtje të mjedisit jetësor nga ujërat e lëshuara dhe shpenzimet për mirëmbajtje të recipientit dhe paguhet në pajtim me kushtet në marrëveshje.

Neni 35

Kompensimi për sasi të dërguar të ujit për furnizim me ujë dhe për nevoja industriale

(1) SHA Ekonomia e Ujërave paguan kompensim për sasi të dërguar të ujit për furnizim me ujë dhe ujë për nevoja industriale në bazë të marrëveshjeve të lidhura me shfrytëzuesit në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet shumën e shpenzimeve për sasi të dërguara të ujit të shfrytëzuesit, sipas volumit të tij dhe paguhet në muaj pas dërgimit të kryer.

(3) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni mund të llogaritet sipas sistemit për premi.

(4) Premia paraqet mënyrën e përcaktimit të kompensimit në bazë të shkallës më të lartë të sigurisë për furnizim me ujë, të cilën e kërkon shfrytëzuesi nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Premia si mënyrë e përcaktimit të kompensimit, doemos duhet të jetë e definuar në protokollin për siguri të furnizimit me ujë i cili është përcaktuar me statutin e SHA Ekonomia e Ujërave dhe doemos duhet të vendoset në marrëveshjen afatgjatë.

(6) Lartësia e premisë përcaktohet me marrëveshje ndërmjet SHA Ekonomia e Ujërave dhe shfrytëzuesit.

VII. DETYRIME TË VEÇANTA

Neni 36

Azhurnimi dhe evidencat

SHA Ekonomia e Ujërave:

- teknikisht e definojnë dhe azhurnojnë hartën në të cilën është paraqitur rajoni i veprimit;
- i evidencojnë të gjitha pjesët përbërëse të sistemit që i barten në shfrytëzim;
- i evidencojnë të dhënat për ujin i cili përfshihet nga burimi;
- i evidencojnë shfrytëzuesit sipas llojit të shërbimeve të siguruar;
- i evidencojnë aktvendimet për kompensim të shërbimeve, detyrime të papaguara dhe të paguara nga shfrytëzues të shërbimeve;
- i evidencojnë marrëveshjet e lidhura, të realizuara dhe porealizuara dhe transaksionet për realizimin e tyre;
- kryejnë regjistrim të mjeteve themelore;
- përpilojnë procesverbal për kontroll dhe incizim të gjendjes të sistemit me të cilin ekonomizon, në tërësi si dhe të pjesëve të sistemit të cilat i janë bartur në shfrytëzim dhe
- kryejnë edhe punë të tjera të vëna në kompetencë të tij me ligje ose rregulla të miratuara në bazë të ligjit.

Neni 37

Zbatimi i ligjit

Organ kompetent për zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Neni 38

Mbikëqyrja profesionale

(1) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave nëpërmjet Drejtorisë për Ekonomi të Ujërave kryejnë mbikëqyrje profesionale në punën e SHA Ekonomia e Ujërave.

(2) Në kornizën të mbikëqyrjes të këtij ligji, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, ka të drejtë të kërkojë nga bordi kontroll në dokumentet e natyrës financiare, materiale dhe tjetër dhe të sugjerojë në punën kundërligjore dhe procedurat të cilat e pengojnë punën e rregullt.

(3) Personat e autorizuar nga Drejtoria për Ekonomi të Ujërave zbatojnë mbikëqyrje profesionale dhe për mangësitë e përcaktuara në punë, i japin orientime SHA Ekonomia e Ujërave për ndërmarrje të veprimeve për:

- mirëmbaje të rregullt të infrastrukturës;
- parandalim të ndodhjes së dëmeve në infrastrukturë;
- parandalim të krijimit të dëmeve në objekte me interes publik, të cilat nuk janë në përbërje të sistemit, ose të objekteve në pronë të personave juridikë ose fizikë dhe
- sigurim të shfrytëzimit të rregullt të infrastrukturës nga aspekti i interesit publik.

Neni 39

Përgjigja me shkrim

(1) Nëse pas kontrollit të realizuar, përcaktohet cenim i rregullave ligjore, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave do t'i njoftojë organet e menaxhimit të SHA Ekonomia e Ujërave për konstatimet e tij nga konstatimet e kontrollit dhe nga ai do të kërkojë përgjigje me shkrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

(2) Nëse organet e menaxhimit të SHA Ekonomia e Ujërave nuk përgjigjet në kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni nga ky ligj, ose nëse pas pranimit të përgjigjes, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave përcakton se SHA Ekonomia e Ujërave ka punuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose rregulla të tjera, do ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 40

Detyrimi për informim

(1) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave nëpërmjet Drejtorisë për Ekonomi të Ujërave me shkrim mund të kërkojë nga organet e menaxhimit të SHA Ekonomia e Ujërave t'i dorëzojnë informata dhe dokumentacion për shfrytëzim dhe mirëmbajtje të sistemit me të cilin ekonomizon.

(2) Nëse organet të menaxhimit të SHA Ekonomia e Ujërave nuk përgjigjen në kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, ose nëse pas pranimit të përgjigjes, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave përcakton se SHA Ekonomia e Ujërave ka punuar në kundërshtim me dispozitat të këtij ligji ose rregulla të tjera, do ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 41

Mbikëqyrja inspektuese

Mbikëqyrje inspektuese nga aspekti i shfrytëzimit të ujërave, gjendja e objekteve të ekonomisë së ujërave dhe infrastrukturës, kryen Inspektorati Shtetëror për Mjedis Jetësor nëpërmjet inspektorëve të ekonomisë së ujërave në pajtim me kompetencat të cilat dalin nga Ligji për ujëra.

VIII. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 42

Sanksion kundërvajtës për SHA Ekonomia e Ujërave

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje SHA Ekonomisë së Ujërave, nëse:

- pa arsye nuk kryen ujitje ose kullim të personave fizikë dhe juridikë në rajonin e veprimit të vet (neni 6);

- nuk i realizon kompetencat të veta dhe nuk e kryen veprimtarinë për të cilën është themeluar (neni 9 paragrafët 1 dhe 2);

- nuk i plotëson kushtet ligjore dhe kërkesat, nuk i siguron lejet e nevojshme, lejet dhe autorizime tjera në lidhje me shfrytëzimin e resurseve ujore dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës, të cilat kanë të bëjnë me ekonomizimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit (neni 9 paragrafi 3);

- nuk kryen furnizim me ujë në bazë të marrëveshjes së lidhur dhe/ose kryen furnizim me ujë pa marrëveshje të lidhur (neni 20);

- nuk i kryen punët e kullimit (neni 21);
- pa arsye nuk kryen kthimin e ujërave të lëshuara për të cilat ka lidhur marrëveshje (neni 22);
- nuk u dërgon ujë ndërmarrjeve komunale dhe/ose nuk dërgon ujë për prodhim të energjisë elektrike në bazë të marrëveshjeve të lidhura (neni 23)
- nuk e shpërndan fitimin dhe nuk e mbulon humbjen (neni 28);
- nuk i përcakton kompensimet të veta për shërbimet (neni 33);
- nuk kryen azhurnim dhe evidencë (neni 36) dhe
- nuk dorëzon informata dhe dokumentacion për shfrytëzim dhe mirëmbajtje të sistemeve me të cilat ekonomizon (neni 40).

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në SHA Ekonomia e Ujërave.

Neni 43

Sanksion i kundërvajtjes për person juridik

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik – shfrytëzues, nëse:

- pa marrëveshje të lidhur me SHA Ekonomia e Ujërave shfrytëzon ujë nga sistemi (neni 19);
- pa marrëveshje të lidhur me SHA Ekonomia e Ujërave lëshon ujë në sistemin për kullim (neni 22);

- krahas ekzistimit të aktvendimit të plotfuqishëm ose aktvendimit sipas të cilit kundërshtimi nuk e mban kryerjen do të pengojë person të autorizuar të SHA Ekonomia e Ujërave në qasje ose shfrytëzim të tokës për kryerje të punëve nga nenet 12 dhe 13 të këtij ligji dhe

- vepron në kundërshtim me procedurat e caktuara me aktet e SHA Ekonomia e Ujërave (neni 17).

(2) Gjobë nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i shqiptohet personit juridik për dëmtim, shkatërrim dhe vjedhje të infrastrukturës dhe objekteve për ujitje, si dhe vjedhje të ujit.

(3) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni dhe personit përgjegjës te personi juridik.

(4) Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni personit juridik – shfrytëzues mund t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të veprimtarisë, profesionit ose detyrës së caktuar në kohëzgjatje prej së paku një deri në dy vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

Neni 44

Sanksioni i kundërvajtjes për person fizik

(1) Gjobë në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga neni 43 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji edhe personit fizik – shfrytëzues i ujit.

Neni 45

Procedura e kundërvajtjes dhe procedura për barazim

(1) Për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj procedurë të kundërvajtjes mban edhe sanksion të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente.

(2) Para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës së kundërvajtjes zbatohet procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 46

Afatet për parashkrim dhe zbatim

Për parashkrimin e ngritjes dhe mbajtjen e procedurës kundërvajtëse si dhe për parashkrim të zbatimit të sanksioneve kundërvajtëse në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat të Ligjit për kundërvajtje.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 47

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të themelojë SHA Ekonomi të Ujërave më së voni deri në ditën e zbatimit të këtij ligji.

(2) Deri në fillim me zbatim të këtij ligji, Ekonomitë e Ujërave ekzistuese vazhdojnë me punë në pajtim me Ligjin për ekonomi të ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 85/2003, 95/2005, 103/2008, 1/12 dhe 95/12).

(3) Me fillimin me zbatim të këtij ligji, Ekonomitë e Ujërave ekzistuese vazhdojnë të punojnë si njësi rajonale të SHA Ekonomia e Ujërave.

(4) Deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji Qeveria e Republikës së Maqedonisë pas propozimit të ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave do të miratojë vendim për ndërprerje të punës së EU Prespë nga Resnja, në pajtim me Ligjin për ekonomi të ujërave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 85/2003, 95/05, 103/2008, 1/12 dhe 95/12).

(5) Me ditën e themelimit të SHA Ekonomia e Ujërave nga paragrafi (1) i këtij neni, prona, pajisja, mjetet për punë dhe mjetet tjera, arkivi, dokumentacioni, të punësuarit, të drejtat dhe detyrimet të Ekonomive të Ujërave ekzistuese i merr SHA Ekonomia e Ujërave nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) SHA Ekonomia e Ujërave nga paragrafi (1) i këtij neni është trashëgimtar juridik i të drejtave dhe detyrimeve të Ekonomive të Ujërave ekzistuese nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 48

Hidrosistemet, sistemet për ujitje dhe sistemet për kullim të cilat janë në pronë të Republikës së Maqedonisë, ndërsa me të cilat deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji nuk kanë ekonomizuar Ekonomitë e Ujërave ekzistuese nga neni 47 paragrafi (2) të këtij ligji as persona tjerë juridikë, i merr SHA Ekonomia e Ujërave nga neni 47 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 49

Aktet nënligjore miratimi i të cilëve është përcaktuar me këtë ligj do të miratohen në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 50

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për ekonomi të ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 85/2003, 95/2005, 103/2008, 1/12 dhe 95/12).

Neni 51

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 tetori 2015.